



SHËRBESA E RRËFIMIT

ATI SHPIRTOR e shpie atë që dô të rrëfëhet përpara Korës së Zotit tonë Jesu Krisht, e thotë :

Shënt Perëndi...

Trini e tërëshëntë...

Ati ynë që je ndë qiell...

Se jotja është mbretëria...

Mëshirô, ô Zot. (12 herë.)

Eni le t' i falemi e t' i biem nër këmbë Perëndisë Mbretit tonë. Eni le t' i falemi e t' i biem nër këmbë Krishtit, Perëndisë dhe Mbretit tonë. Eni le t' i falemi e t' i biem nër këmbë vetë Krishtit, Perëndisë dhe Mbretit tonë. (Tri falje.)

PSALM 51.

Përdëllyes, përdëllë-më, ô Perëndi....

Pastaj këtë Tropare :

Mëshirô-na, ô Zot, ... (Shëkô në 'Blatë.)

LAVDË :

Mëshirô-na, ô Zot...

TANË :

Hap-na derën e zëmër-dhëmpshërisë...

Mëshirô, ô Zot. (12 herë.)

Pastaj thotë PRIFTI :

O Perëndi, shpëtimtari ynë, që i dhurove ndjesë fajesh Davidit që u-pendua me anën e Profetit tënt Nathan, dhe prite faljen e pendimit të Manasiut ; Ti, pas njerzidashjes s' ate së zakonëshme, prit dhe shërbëtorin tënt (aksh) që pendohet për fajet që ka bërë, duke çvështruar tërë atô që ka bërë, ti që fal paudhësitë dhe nuk i vë re paligjësitë. Se ti the, ô Zot : Nukë desha me dëshirë vdekjen e mëkatarit, po kthimin e rrojtjen e tij ; dhe që do t' i ndjesh fajet gjer më shtatëdhjetë herë shtatë ; se madhështia jote është e papërqasur dhe mëshira jote e panëmëruar ; se në vënç re paligjësitë, kush do t' qëndrojë ? Se ti je Perëndi e atyre që pendohen dhe ty të dërgojmë lavdî, Atit, e Birit, edhe Shpirtit Shënt, tanî e përherë, e në jetë të jetëve. Amen.

Pastaj këtë Urim :

Le t' i lutemi Zotit.

O Zot Jesu Krisht, Bir' i Perëndisë së gjallë, bariu dhe qëngji, që ngre mëkatën e botës, që u fale huan të dy detorëve, dhe i dhurove mëkatares ndiesë të mëkatave të saj ; Ti, ô Zot i Math, ndjej-i, fal-i mëkatat, paligjësitë, fajet e dashura dhe të padashura, me dijë, me padijë të cilat bënë shërbëtorët e tû. Dhe, në qoftë se si njerës me mish që rrinë në botë u-gënjyen prej Diallit, ose me fialë, ose me punë, ose me dijë, ose me padijë, ose në

shkelë fialë Prifti, a ranë në mallkim Prifti, ose n' anathemë të tij, ose shkelë ben' e tyre ; 'Ti, si Zot i mirë dhe zëmër-bardhë, dignô t' i falësh shërbëtorët e tû pas mëshirës s' ate së madhe.

Po, ô Zot njerzidashës, dëgjô-na që po i lutemi mirësisë s' ate për këtë shërbëtorët e tû, dhe mos i vër re si mëshirëplot fajet e tyre ; shpëtoj-i prej Ferrit të përjetëshëm ; se ti the, ô Zot : Sa të lithni mi dhê, do të jenë të lidhura në qiell ; dhe sa të zgjithni mi dhê, do të jenë të zgjidhura në qiell. Se ti je i vetëmi i pamëkatëshëm, dhe ty të dërgojmë lavdî, Atit, e Birit, edhe Shpirtit Shënt, tanî e përherë, e në jetë të jetëve. Amen.

Pastaj PRIFTI i thotë të penduarit :

Vëllâ, mos kî turp për atë që erdhe te Perëndia dhe te mua ; se nuk m' i thua mua, po Perëndisë, përpara të cilit qëndron.

Dhe më parë e pyet për besën e tij.

Beson, ô im-bir, m' atô që na mëson Kish' e shëntë e Përgjithëshme dhe Apostollore ?

I penduari thotë Symbolin e fesë :

Besoj më një Perëndî...

Pastaj Prifti e pyet me radhë për gjithë mëkatat dhe, passi mbaron, e këshillon që të mos i përsëdytë. Pasandaj i thotë :

Përgjunj-u.

I penduari përgjunjet, Prifti i vë dorën mi krye dhe thotë :

Le t' i lutemi Zotit

O Zot, Perëndi e shpëtimit të shërbëtorëve tënt, hirëplot, mëshirëmath, e zëmërgjerë, që të vien keq për punët tona të liga dhe nuk dëshëron vdekjen e mëkatarit, po përpiqesh t' a kthesh nga udha e prapë që të rrojë me të vërtetë : Rrëfë mëshirën tënde dhe mi shërbëtorin tënt dhe fal-i shëmbëll pendimi, ndiesë të mëkatave, dhe çlirim prej ç' dō të keqeje. Fal-i ç' do faj të dashur a të padashur. Pajtoj-e dhe bashkoj-e me Kishën tënde të shëntë me anën e Zotit tonë Jesu Krisht, me të cilin të ka hie ç' do lavdi, bashkë me Shpirtin tënt Jetëdhënës, tanî e përherë e në jetë të jetëve. Amen,

Zoti ynë Jesu Krisht me hirë dhe njerzidashjen e tij le të t' i ndjejë gjithë fajet, ô biri im. Dhe unë, Prift i pavyershim, me fuqinë që më ka dhënë ay të ndjej e të çliroj prej gjithë mëkatave të tua, më emërin e Atit, e të Birit, e të Shpirtit Shënt. Amen.

Dhe i bën shënjën e Kryqit mi krye.

(Sh. K. Kiô Shërbesë është shkurtuar pas Librës së Shërbesave Rusishte.)